



Deklaratë për shtyp - 417/05/2020

Hapa të tjerë të planit Nordrhein-Westfalen janë duke u zbatuar – adaptime të planifikuara për masat për mbrojtjen nga koronavirusi

27.05.2020
Faqja 1 nga 3
Zyra për shtyp e kancelarisë së
shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

**Hapja e kufizimeve të kontaktit deri në dhjetë njerëz në hapësira
publike në përputhje me vendimin nga federata dhe nga republikat
/ Vizita në kinema dhe evenimente kulturore si dhe konkurse në
sporte popullore dhe të kohës së lirë janë të mundura nën disa
kushte**

Qeveria e Republikës ju informon:

Duke filluar nga e shtuna, më datë 30 Maj 2020, hapje të tjera të masave për mbrojtjen nga koronavirusi vlejné në Nordrhein-Westfalen për planin për Nordrhein-Westfalen nga qeveria e Republikës. Këto përfshijnë ndër të tjera, hapjen e kufizimit të kontaktit për grupe deri në dhjetë persona në përputhje me marrëveshjen e fundit midis federatës dhe republikave, rregullore për sa i përket zhvillimit të evenimenteve në kinema, teatro, shtëpi operash, salla koncerti dhe institucione kulturore private ose publike si dhe konkurse në sporte popullore dhe të kohës së lirë.

Kryeministri Armin Laschet: „Duke filluar nga hapjet e para më datë 20 Prill, numri i infeksioneve të reja në Nordrhein-Westfalen ka rënë me më shumë se 75 përqind. Ndërkohë që mesatarja javore në prill ishte akoma më shumë se 500, sot është 102 në të gjithë republikën. Njerëzit e republikës sonë meritojnë një falenderim shumë të madh. Sjellja e kujdesshme dhe e përgjegjshme e shumicës për sa i përket përballjes me pandeminë Covid 19 na lejon ne të implementojmë hapa të rinj në planin Nordrhein-Westfalen. Mund të vazhdojmë ciklin e mirëmenduar të hapjeve të vazhdueshme dhe si rrjedhim të ndërmarrim hapin tjetër drejt një normaliteti të përgjegjshëm. Do të vazhdojmë të mbështetemi në bonsensin dhe përgjegjësinë personale të njerëzve në republikën tonë. Duhet të vazhdojmë të mbajmë distancën kurdo që të jetë e mundur dhe të sillemi në mënyrë të përgjegjshme ndaj vetes sonë dhe të tjerëve.“

Plani për Nordrhein-Westfalen mundëson faza të ndryshme me data të planifikuara për sektorë individualë. Kjo avitje i ofron qytetarëve të Nordrhein-Westfalen mbrojtje shëndetësore si dhe parashikueshmëri dhe besueshmëri për jetën ekonomike dhe publike. Hapjet do të zënë vend nën vlerësim të vazhdueshëm dhe kushtëzim të qartë nga zhvillimi i infeksionit. Datat e përmendura janë gjithashtu qartësisht data për të cilat duhen marrë parasysh devijime.

Rregullorja korresponduese ligjore u shpall të mërkurën më 27 Maj 2020 dhe do të hyjë në fuqi më 30 Maj 2020. Është e gatshme tek www.land.nrw.

Rregulloret e reja të detajuara

Rregullorja për mbrojtjen nga koronavirusi e qeverisë së Republikës së Nordrhein-Westfalen mundëson lehtësimet e mëtejshme duke filluar nga data 30 Maj 2020:

1. Kufizimet e kontaktit dhe rregullat e sjelljes

Kufizimet ekzistuese të kontaktit do të zhvillohen më tej në përputhje me vendimin e 26 Majit 2020 midis federatës dhe republikave në mënyrë që krahas sistemeve të bëra mundur më përpara (familje ose dy bashkësi familjare), një grup deri në dhjetë njerëz të mund të takohet në vend publik. Kjo vlen nën kushtin që të jetë i mundur gjurmimi i personave të përfshirë në takim.

Për më tepër, rregullorja e përgjithshme për distancën prej 1.5 metrash vazhdon të jetë e vlefshme, duke përfshirë detyrimin e pajisjes me maskë për mbulimin e gojës dhe të hundës në raste të caktuara.

2. Institucionet kulturore

Kinematë, teatrot, operat dhe sallat e koncertit mund të hapen përsëri për vizitorët, nëse ato kujdesen për mbrojtjen nga infeksioni dhe për higjienën. Kjo vlen edhe për ambientet e evenimenteve në qiell të hapur. Një plan i veçantë për higjienën dhe për mbrojtjen nga infeksioni është i nevojshëm nëse më shumë se çereku i kapacitetit të rregullt të audiencës ose më shumë se 100 njerëz do të jenë spektatorë.

3. Sporti

Grupe njerëzish të cilët janë të lejuar të takohen brenda hapësirës së kufizimit të kontaktit, lejohen gjithashtu të marrin pjesë në sportet pa kontakt në mjedise të hapura. Brenda kësaj hapësire, konkurset për sporte në qiell të hapur në grup dhe të kohës së lirë lejohen sërish me kushtin e zbatimit të një plani higjiene dhe për mbrojtjen nga infeksioni – duke përfshirë përdorimin e dhomave të zhveshjes dhe të mjediseve sanitare nën kushte të caktuara .

Nga ana tjetër, sportet, trajnimet dhe konkurset me kontakt fizik të pashmangshëm qëndrojnë të ndaluara. Pishinat me korsi, gjithashtu në pishina të mbyllura , mund të rifillojnë veprimtarinë e tyre.

4. Ofertat për pushime

Udhëtimet me autobus janë përsëri të mundshme nën kushtet e mbrojtjes nga infeksioni.

5. Panairët e tregtisë, kongreset, konferencat

Panairët e tregtisë, kongreset e tregtisë dhe konferencat e tregtisë lejohen përsëri nën kushtin e planit të mbrojtjes.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Informacion i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave](#)